

VENDIM
Nr.343, datë 29.4.2011

PËR KALIMIN E DISA PASURIVE NË ZONËN KADASTRALE NR.8515, TË QYTETIT TË Durrësit, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT (ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE) DHE AUTORIZIMIN, PËR IDENTIFIKIM E ZBATIM TË PROJEKTIT PËR KOMUNITETIN ROM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, 10, 12, 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurive shtetërore, me numër 7/251, 7/120, 7/333, 7/334, 7/335, 7/336, 7/337, 7/338, 7/339, 7/340, 7/366, 7/367, 7/368 7/369, 7/251, të ndodhura në zonën kadastrale nr.8515 të bashkisë së Durrësit, me sipërfaqe të përgjithshme, sipas shtojcës bashkëlidhur dhe hartës treguese të ZVRRPP-së Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Entit Kombëtar të Banesave), për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

2. Enti Kombëtar i Banesave në truallin sipas pikës 1 të këtij vendimi, të fillojë zbatimin dhe ndërtimin e “Banesave sociale tip, me mjedise rekreative për komunitetin rom”, në kuadër të projektidesë “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom - dekada e romëve”.

3. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave, që, brenda 1 (një) viti, të identifikojë, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore, në 6 (gjashtë) rrethe të territorit të Republikës së Shqipërisë, pasuri shtetërore, të përshtatshme në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ku pjesë përbërëse të jetë zbatimi i projektidesë “Banesa sociale tip, me mjedise rekreative për komunitetin rom”, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha